

VENDIM
Nr. 54, datë 29.1.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 65, DATË 14.2.2024, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN E ZYRAVE VENDORE TË
AVOKATURËS SË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1.5, të nenit 11, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “ç”, të pikës 1, të vendimit nr. 65, datë 14.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit”, emërtesa “Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Shkodër” zëvendësohet me “Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Lezhë”.
 2. Ngarkohet Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku